



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 3009 / prot  
5

Tiranë, më 06. F. 2018

URDHËR

Nr. 436, datë 06. F. 2018

“PËR

**MOS LICENCIMIN E SHOQATËS “ELITE” SI AGJENCI E ADMINISTRIMIT  
KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË ARTISTËVE INTERPRETUES DHE  
EKZEKUTUES”**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të *Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*, nenit 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*”, udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016 “*Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”*; si dhe kërkesës së shoqatës “ELITE” për pajisjen me licencë me nr. 3009 prot., datë 2.5.2018, Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018 “*Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim /ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”*, ndryshuar me Urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018 “*Për një ndryshim në Urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018*”, si dhe legjislacionin në fuqi “*Për Organizatat Jo-fitimprurëse*”;

**K O N S T A T O V A :**

- a. Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, në fushën e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues, si dhe nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit të depozituar nga shoqata “ELITE”, memos dhe relacionit të hartuar nga grupi i punës, rezulton se kjo shoqatë nuk i plotëson kriteret që ligji përcakton për t’u pajisur me licencë, si agjenci e administrimit kolektiv.

## URDHËROJ:

1. Mos licencimin e shoqatës “ELITE”, si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
3. Kundër këtij urdhri, kërkuesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

*Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

**MINISTRI**  
**Mirela KUMBARO FURXHI**

